REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 61/4 Prot. Vlorë më, 09.01. 2025

VENDIM

Nr.4, datë 09.01.2025

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË EMRIT TË QENDRAVE KËRKIMORE SHKENCORE DHE NDRYSHIMIN E NENIT 78 NË STATUTIN E UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 33, 49, pika 1, gërma gj, të Ligjit nr.80/2015 *"Për arsimin e lartë dhe kerkimin shkencor, në institucionet arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"* nenit 25 të Statutit të UV-së, si dhe referuar propozimeve të Rektorit të UV-së, ardhur me shkresat nr.3, prot, datë, 06.01.2025, shkresa nr. 50, prot, datë, 08.01.2025, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 09.01.2025,

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin e nenit 11, pika 2, si më poshtë;
   **Ishte**: Neni 11, pika2,

1. Në UV funksionojnë këto qendra kërkimore-shkencore:
   a) Qendra e Kërkimore-Shkencore e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore;
   b) Qendra e Kërkimore-Shkencore e Fakultetit të Ekonomisë;
   c) Qendra e Kërkimore-Shkencore e Shëndetit Publik;
   d) Qendra e Kërkimore-Shkencore e Albanologjisë dhe Ballkanistikës.

**Bëhet**: Neni 11, pika2

2. Në UV funksionojnë këto qendra kërkimore-shkencore:
   e) Qendra e Kërkimore-Shkencore në Shkencat e Aplikuara
   f) Qendra e Kërkimore-Shkencore për Inovacion dhe Teknologji
   g) Qendra e Kërkimore-Shkencore e Shëndetit
   h) Qendra e Kërkimore-Shkencore e Albanologjisë dhe Ballkanistikës.

2. Të miratojë ndryshimin e nenit 78, si më poshtë;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

**Ishte:** Neni 78, pika 4

**Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit**

Statusi i studentit nuk mund të vazhdojë për një kohëzgjatje më të madhe se dyfishi i kohëzgjatjes normale të programit të studimit të zgjedhur. Në rast se kjo kohë tejkalohet, kryesekretari i fakultetit i propozon dekanit çregjistrimin e studentit. Procedurat e çrregjistrimit përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.

**Bëhet**: Neni 78, pika 4

**Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit**

4. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë së se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.Procedurat e çrregjistrimit përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.

**Shtohet pika 5**

5. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet në të njëjtin program studimi ose një program tjetër. Ai u nënshtrohet kritereve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të institucionit pritës. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen me vendim të njësisë bazë të institucionit që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e saj.

3. Vendimi përcillet për miratim të mëtejshëm në Senatin Akademik.
4. Këto ndryshime të pasqyrohen edhe në Statutin përfundimtar të UV-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Sotir NIKOLLA**

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORI

Nr. 3 Prot. Vlorë më, 06.01.2025

**Lënda:** Përcjellje për mendim në Bordin e Administrimit, për ndryshimin e emërtimit të Qendrave Kërkimore Shkencore në fakultetet e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

**BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË**
**Z. SOTIR NIKOLLA**

**KËTU**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, gërma c, të ligjit Nr.80/2015"*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",* nenit 19, pika 1, gërma c, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, referuar shkresës 3085, prot, datë, 23.12.2024, të Fakultetit të Ekonomisë, vendimit të Dekanatit nr.14, datë, 11.12.2025, të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, shkresës Nr. 240/4 të Fakultetit të Shëndetit, prot, datë, 04.12.2024, po ju përcjellim ndryshimet në nenin 11, të Statutit të UV-së si më poshtë vijon:

**Ishte:** Neni 11, pika 2,

Në UV funksionojnë këto qendra kërkimore- shkencore

a) Qendra e kërkimit shkencor e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore.
b) Qendra e kërkimit shkencor e Fakultetit të Ekonomisë.
c) Qendra e Kërkimit shkencor e Shëndetit Publik.
d) Qendra e kërkimit shkencor e Albanologjisë dhe Ballkanistikës.

**Bëhet:**

Në UV funksionojnë këto qendra kërkimore- shkencore:

a) Qendra Kërkimore Shkencore në Shkencat e Aplikuara.
b) Qendra Kërkimore Shkencore për Inovacion dhe Teknologji.
c) Qendra Kërkimore Shkencore e Shëndetit.
d) Qendra e kërkimit shkencor e Albanologjisë dhe Ballkanistikës.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

**REKTOR**

**Prof. Dr. Aurela Saliaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**SEKTORI JURIDIK**

Nr.3/1 Prot. Vlorë më 08.01. 2025

**Lënda:** Interpretim në lidhje me propozimin për ndryshimin e emrit të qendrave kërkimore- shkencore.

**REKTORIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË**
**PROF.DR. AURELA SALIAJ**

**KËTU**

Sektorit Juridik i është përcjellë për interpretim shkresat nr. 540/4 prot, datë 04.12.2024 protokolluar pranë nesh me nr.3009 prot, datë 19.12.2024 e Dekanit të Fakultetit të Shëndetit, shkresa nr. 310/3 prot, datë 11.12.2024 protokolluar pranë nesh nr. 2133/2 prot, datë 12.12.2024, shkresës nr. 267/5 prot, datë 23.12.2024 protokolluar pranë nesh me nr. 3085 prot, datë 23.12.2024 ju informojmë se Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë është i organizuar në 4 qendra kërkimore shkencore në mbështetje të nenit 11 të Statutit: Qendrat kërkimore-shkencore:

1. Fakultetet e UV-së kanë në përbërjen e tyre edhe qendra kërkimore-shkencore. Ato miratohen nga Senati Akademik, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi dhe kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi.
2. Në UV funksionojnë këto qendra kërkimore-shkencore:
   a) Qendra e kërkimit shkencor e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore;
   b) Qendra e kërkimit shkencor e Fakultetit të Ekonomisë;
   c) Qendra e kërkimit shkencor e Shëndetit Publik;
   ç) Qendra e kërkimit shkencor e Albanologjisë dhe Ballkanistikës.
3. Qendrat kërkimore-shkencore kanë në përbërjen e tyre, në çdo rast një përgjegjës personel akademik, personel akademik si dhe punonjës ndihmësakademik.
4. Kur plotësojnë standardet (kushtet dhe kriteret) e njësisë bazë, ato llogariten për qëllimin e përmbushjes së standardeve institucionale. Qendrat kërkimore-shkencore të fakulteteve që plotësojnë standardet e njësisë bazë janë struktura universitare që mund të organizohen në grupe kërkimore-shkencore.
5. Qendrat kërkimore-shkencore mund të mbështetin realizimin e programeve të studimit "Master i shkencave" dhe "Doktoratë" të ofruara nga departamentet e fakultetit ose departamentet e fakulteteve të tjera.
6. Përbërja, funksionimi dhe drejtimi më i detajuar i QKSH-ve të fakulteteve përcaktohen në aktet e tjera të brendshme të institucionit, në rregulloret e organizimit dhe funksionimit të tyre të miratuara në dekanatet e fakulteteve dhe në SA.

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**SEKTORI JURIDIK**

Qendra e kërkimit shkencor e Shëndetit Publik në mbështetje të nenit Neni 26 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ka funksionin e njësisë bazë dhe ka në përbërje të tij më tepër se shtatë anëtarë, në dallim nga tre qendrat e tjera në fakultetet e tjera të UV-së pasi nuk kanë funksionin e njësisë bazë.

Qendra kërkimore-shkencore
*1. Qendra kërkimore-shkencore e fakultetit ose e institutit është njësi bazë që kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi. 2. Qendra mund të mbështetë realizimin e programeve të studimeve "Master i shkencave" dhe "Doktoratë", të ofruara nga departamentet e fakultetit përkatës ose departamente të fakulteteve të tjera. 3. Struktura e qendrës, përbërja, funksionimi dhe drejtimi i saj përcaktohen në statutin dhe në aktet e tjera të institucionit të arsimit të lartë. 4. Kur qendra nuk përmbush standardet njësisë bazë, ajo nuk llogaritet për qëllimin e përmbushjes së standardeve institucionale, si njësi bazë e njësisë kryesore.*

Duke patur parasysh se kjo vendimarrje për ndryshimin e emrit për dy qendrat e kërkimit shkencor në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore dhe Fakultetin e Ekonomisë nuk ka efekte financiare dhe nuk ndryshojnë funksionin dhe organizimin e këtyre qendrave propozojmë që ndryshimi i emërtimit të kalojë për miratim pranë Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik dhe këto ndryshime të pasqyrohen në Statut.

Sa i përket ndryshimit të emrit të Qendrës kërkimore shkencore të Fakultetit të Shëndetit duke qenë se kjo qendër është njësi bazë që kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi dhe nga propozimi i paraqitur kërkohe dhe shtim të numrit të personelit akademik nga 11 në 12 i cili shoqërohet me efekt financiar propozojmë që organet kolegjiale të UV të mund të miratojnë ndryshimin e këtij emri dhe më qëllim kapjen e afateve që statuti të paraqitet i plotë me ndryshime ne MAS nga ana e ksaj njësie kryesore duhet të iniciohet propozimi për riorganizimin e qendrës si dhe UV t'i drejtohet MAS për aprovimin e këtij riorganizimi në zbatim të Udhëzimit Nr. 1, Datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**PËRGJEGJËS SEKTORI**
**Gentjana BELULAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEKANI

Nr. 540/4 Prot. Vlorë, më 04.12.2024

Lënda: Propozim për disa ndryshime në Strukturën akademike të Fakultetit të Shëndetit

**PROF. DR. AURELA SALIAJ**
**REKTOR I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË**

**KËTU:**

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 2132/4 Prot., datë 04.12.2024 dhe në mbështetje të pikës 2 dhe 3 të nenit 23, pikës 4, 5 dhe 11 të nenit 25 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", gërmës c, pikës 4 të nenit 9, pikës 2 dhe gërmës ë dhe f të pikës 3 të nenit 10, gërmës c të pikës 2, dhe pikës 4 të nenit 11, gërmës dh të pikë 2 të nenit 27 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, gërma D e nenit 12, dhe neni 19 i Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Dekanati i Fakultetit të Shëndetit në mbledhjen e datës 4 Dhjetor vendosi ti paraqesi Rektoratit dhe Senatit Akademik të Univeërsitetit "Ismail Qemali", Vlorë disa ndryshime strukturore në strukturën akademike të Fakultetit të Shëndetit. Propozimet kanë të bëjnë me disa ndryshime në Vendimet e Senatit Akademik Nr. 82, datë 12.12.2016 "Për ngritjen dhe funksionimin e grupeve mësimore dhe kërkimore-shkencore në Njësitë Bazë të Fakultetit të Shëndetit", Vendimin e Senatit Akademik Nr. 8, datë 14.02.2018 me Nr. 230/2 Prot., datë 15.02.2024, "Për Strukturën Organizative të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, i ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik Nr. 12, datë 27.02.2019 me Nr. 352/2 Prot., datë 01.03.2019, dhe Vendimin e Senatit Akademik Nr. 53, datë 26.09.2019 "Për rialokimin e numrit të personelit akademik nga Fakulteti i Shkencave Teknike tek Fakulteti i Shëndetit" dhe Vendimin e Senatit Akademik Nr. 25 datë 08.05.2018 me Nr. 654/6 Prot. dtë 21.05.2018 "Për riorganizimin e grupeve mësimore, kërkimore-shkencore të Njësive Bazë të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë".

Adresa /Adress: L. Pavarsia, Bulevardi Vlore-Skele
web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



Scanned with CamScanner

Këto propozime janë rrjedhojë e ndryshimeve në legjislacionin në fuqi dhe më specifikisht në VKM-së Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar me VKM nr. 879, datë 18.12.2019 dhe VKM nr.185, datë 25.03.2021, VKM-së Nr. 823, Datë 28.12.2023 për "Disa Shtesa dhe Ndryshime në Vendimin nr. 41, Datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë". Në bazë të këtye ndryshimeve ligjore, Fakulteti i Shëndetit ka kërkuar riorganizimin e planeve mësimore. Një nga ndryshimet thelbësore në këtë VKM është dhe se 1 kredit është i barazvlefshëm me 25 deri në 30 orë. Në bazë të riorganizimeve të bëra nga Njësitë Bazë të Fakultetit të Shëndetit, është parashikuar që 1 kredit të jetë i barabartë me 30 orë mësimore. Kjo rrit ngarkesën totale të të programit mësimor nga 4500 orë që ishte aktualisht në 5400 orë. Paralelisht, Fakulteti i Shëndetit ka numrin më të lart të studentëve në Universitetin "Ismail QemalI' Vlorë dhe me qëllim mirëmbjtjen, mirëfunksionimin dhe mirëorganizimin e punës është e nevojshme të rritet numri i zv. Dekanëve nga 1 në 2. Po ashtu, kërkimi shkencor në Fakultetin e Shëndetit është prioritet. Numri i punimeve shkencore të Fakultetit të Shëndetit është rritur ndërsa aplikimet në projekte me financim këmbëtar dhe ndërkombëtar ka patur një rritje të konsiderueshme vitet e fundit. Organizimi i Qendrës Kërkimore në grupe kërkimore do të japi mundësinë për profilizim më të lart të stafit akademik me qëllim tërheqjen e më shumë fondeve kërkimore. Bazuar në këto më lart si dhe në vendimin e Dekanatit të Fakultetit të Shëndetit Nr. 19 datë 03.12.2024 me Nr. 540/2 Prot., datë 03.12.2024, propozojm:

- Rritja e numrit të zv. Dekanëve nga 1 në 2 me krijimin e pozicionit të Zv. Dekanit për anën Mësimore;
- Ndryshimin e emërtimit të Qendrës Kërkimore nga Qendra Kërkimore Shkencore e Fakultetit të Shëndetit në "Qendra Kërkimore Shkencore e Shëndetit";
- Laboranti i Laboratorit Klinik-Mikrobiologjik kalon në varësi të Dekanit nga Qendra Kërkimore Shkencore e Fakultetit të Shëndetit siç është vendosur me Vendim Dekanati të Fakultetit të Shëndetit me Nr. 6 datë 15.12.2024 me Nr. 319/1 Prot., datë 15.12.2024;
- Numri i stafit akademik të Departamentit të Infermierisë nga 12 bëhet 14;



Scanned with CamScanner

- Numri i stafit akademik të Departamentit të Kujdesit Shëndetësor nga 11 bëhet 14;
- Numri i stafit akademik të Qendrës Kërkimore Shkencore nga 11 bëhet 12;
- Në Departamentin e Infermierisë riorganizohen grupet mësimore dhe grupet me karakter kërkimor-shkencor dhe krijohet Grupi Mësimor i Infermierisë dhe Grupi kërkimor-shkencor i përkohshëm i Infermierisë;
- Në Departamentin e Kujdesit Shëndetësor riorganizohet Grupi Kërkimor i politikave Shëndetësore dhe bëhet Grupi kërkimor-shkencor i përkohshëm për grupet vulnerable dhe pabarazitë shëndetësore;
- Në Departamentin e Kujdesit Shëndetësor riorganizohet Grupi mësimor dhe krijohet Grupi Mësimor i Kujdesit Shëndetësorë;
- Në Qendrën Kërkimore Shkencore të Shëndetit Publik krijohen dy grupe kërkimore-shkencore të cilat janë Grupi kërkimor-shkencor i përkohshëm "Shëndeti i të rriturve, kujdesi kronik dhe politikat shëndetësore", dhe Grupi kërkimor-shkencor i përkohshëm "Determinantët e shëndetit, ndryshimet klimatike dhe impakti në shëndet".

Bashkëlidhur gjeni:

- Vendimin e Dekanatit Nr. 19 datë 03.12.2024 me Nr. 540/2 Prot., datë 03.12.2024.
- Strukturën dhe organigramën e propozuar të Fakultetit të Shëndetit.

Ju faleminderit për bashkpunimin!

**DEKANI**
**Prof. Asoc. Enkelejd Mehilli**

Adresa /Adress: L. Pavarsia,
Bulevardi Vlore-Skelë

web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



Scanned with CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**
**FAKULTETI I SHËNDETIT**
**DEKANI**

Nr. 540/13 Prot. Vlorë, më 03.11.2024

**VENDIM**
**Nr. 19 datë 03.12.2024**

**MBI**
**PROPOZIMIN E STRUKTURES SE FAKULTETIT TË SHËNDETIT**

Në mbështetje të pikës 2 dhe 3 të nenit 23, pikës 4, 5 dhe 11 të nenit 25 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", gërmës c, pikës 4 të nenit 9, pikës 2 dhe gërmës ë dhe f të pikës 3 të nenit 10, gërmës c të pikës 2, dhe pikës 4 të nenit 11, gërmës dh të pikë 2 të nenit 27 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, gërma D e nenit 12, dhe neni 19 i Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Dekanati i Fakultetit të Shëndetit në mbledhjen e datës 4 Dhjetor vendosi ti paraqesi disa rekomandime Rektoratit dhe Senatit Akademik disa ndryshime strukturore në strukturën e Fakultetit të Shëndetit. Propozimet kanë të bëjnë me disa ndryshime në Vendimet e Senatit Akademik Nr. 82, datë 12.12.2016 "Për ngritjen dhe funksionimin e grupeve mësimore dhe kërkimore-shkencore në Njësitë Bazë të Fakultetit të Shëndetit", Vendimin e Senatit Akademik Nr. 8, datë 14.02.2018 me Nr. 230/2 Prot., datë 15.02.2024, "Për Strukturën Organizative të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, i ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik Nr. 12, datë 27.02.2019 me Nr. 352/2 Prot., datë 01.03.2019, dhe Vendimin e Senatit Akademik Nr. 53, datë 26.09.2019 "Për rialokimin e numrit të personelit akademik nga Fakulteti i Shkencave Teknike tek Fakulteti i Shëndetit" dhe Vendimin e Senatit Akademik Nr. 25 datë 08.05.2018 me Nr. 654/6 Prot. dtë 21.05.2018 "Për riorganizimin e grupeve mësimore, kërkimore-shkencore të Njësive Bazë të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë":

**VENDOSI:**

1. Rritjen e numrit të zv. Dekanëve nga 1 në 2 me krijimin e pozicionit të Zv. Dekanit për anën Mësimore;
2. Ndryshimin e emërtimit të Qendrës Kërkimore nga Qendra Kërkimore Shkencore e Fakultetit të Shëndetit në "Qendra Kërkimore Shkencore e Shëndetit";

Adresa /Adress: L. Pavarsia,
Bulevardi Vlorë-Skelë

web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



Scanned with CamScanner

3. Laboranti i Laboratorit Klinik-Mikrobiologjik kalon në varësi të Dekanit nga Qendra Kërkimore Shkencore e Shëndetit siç është vendosur me Vendim Dekanati të Fakultetit të Shëndetit me Nr. 6 datë 15.12.2023 me Nr. 319/1 Prot., datë 15.12.2023.
4. Numri i stafit akademik të Departamentit të Infermierisë nga 12 bëhet 14;
5. Numri i stafit akademik të Departamentit të Kujdesit Shëndetësor nga 11 bëhet 14;
6. Numri i stafit akademik të Qendrës Kërkimore Shkencore të Shëndetit nga 11 bëhet 12;
7. Në Departamentin e Infermierisë riorganizohen grupet mësimore dhe grupet me karakter kërkimor-shkencor dhe krijohet Grupi Mësimor i Infermierisë dhe Grupi kërkimor-shkencor i përkohshëm i Infermierisë;
8. Në Departamentin e Kujdesit Shëndetësor riorganizohet Grupi Kërkimor i politikave Shëndetësore dhe bëhet Grupi kërkimor-shkencor i përkohshëm për grupet vulnerable dhe pabarazitë shëndetësore;
9. Në Departamentin e Kujdesit Shëndetësor riorganizohet Grupi mësimor dhe krijohet Grupi Mësimor i Kujdesit Shëndetësorë;
10. Në Qendrën Kërkimore Shkencore të Shëndetit krijohen dy grupe kërkimore-shkencore të cilat janë Grupi kërkimor-shkencor i përkohshëm "Shëndeti i të rriturve, kujdesi kronik dhe politikat shëndetësore", dhe Grupi kërkimor-shkencor i përkohshëm "Determinantët e shëndetit, ndryshimet klimatike dhe impakti në shëndet".
11. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha strukturat akademike dhe ndihmës akademike me karakter akademik dhe karakter administrative të Fakultetit të Shëndetit.
12. Ky vendim i përcillet Rektorit dhe Senatit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DEKANI**
**Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli**

Adresa /Adress: L. Pavarsia, Bulevardi Vlorë-Skelë
web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



Scanned with CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**
**FAKULTETI I SHËNDETIT**
**DEKANI**

## PROPOZIM MBI DISA NDRYSHIME NË STRUKTURËM DHE ORGANIGRAMËN E FAKULTETIT TË SHËNDETIT

## STRUKTURA E FAKULTETIT TË SHËNDETIT

**Fakulteti i Shëndetit**

**Departamenti i Infermierisë**

Koordinatori për marrëdhëniet me studentët për DI

Laboratori i Infermierisë
Laboratori i Anatomisë
Qendra Simulatore

Programe mësimore në:
- Bsc në Infermieri të përgjithshme
- MP në Infermieri Patologjike
- MP në Infermieri Kirurgjikale
- MS në Shkenca Infermierore

**Departamenti i Kujdesit shëndetësor**

Koordinatori për marrëdhëniet me studentët për DKSH

Laboratori i Mamisë
Laboratori i Anatomisë
Qendra Simulatore

Programe mësimore në:
- Bsc në Infermieri Mami
- MP në Infermieri Pediatrike

**Qendra kërkimore-shkencore e Shëndetit**

Laboratori Klinik-Mikrobiologjik



Scanned with CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**
**FAKULTETI I SHËNDETIT**
**DEKANI**

# ORGANIGRAMA E PLANIFIKUAR E FAKULTETIT TË SHËNDETIT




Scanned with CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË**
**FAKULTETI I SHËNDETIT**
**DEKANI**

## STRUKTURA ORGANIZATIVE E PROPOZUAR NË FAKULTETIN E SHËNDETIT

| **Struktura organizative në FSH** | **Nr. personelit** |
|---|---|
| Dekan | Personel akademik |
| Zv. Dekan për anën Mësimore | Personel akademik |
| Zv. Dekan për Kërkimin Shkenocr | Personel akademik |
| Departamenti i Infermierisë | 14 |
| Departamenti i Kujdesit Shëndetësorë | 14 |
| Qendra Kërkimore Shkencore e Fakultetit të Shëndetit | 12 |
| Specialist protokolli/ Asistenti i Dekanit | 1 |
| Kryesekretare | 1 |
| Sekretare mësimore | 2 |
| Laborant i Laboratorit Klinik-Mikrobiologjik | 1 |
| Laboranti i Departamentit të Infermierisë | 2 |
| Laborant i Departamentit të Kujdesit Shëndetësorë | 1 |
| Specialist i Qendrës Kërkimore Shkencore e Fakultetit të Shëndetit | 1 |
| **Totali staf akademik** | **40** |
| **Totali staf ndihmës akademik me karakter akademik** | **5** |
| **Totali staf ndihmës akademik me karakter administrativ** | **4** |



Scanned with CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHËNDETIT
DEKANI

## STRUKTURA AKADEMIKE E PROPOZUAR E FAKULTETIT TË SHËNDETIT

| Nr. | Emër Mbiemër | Pozicioni | Titulli akademik | Grada shkencore |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Emri Mbiemri | Dekan | - | - |
| 2. | Emri Mbiemri | Zv. Dekan për anën Mësimore | - | - |
| 3. | Emri Mbiemri | Zv. Dekan për Kërkimin Shkencor | - | - |
| 4. | Emri Mbiemri | Specialist protokolli/ Asistenti i Dekanit | - | - |
| 5. | Emri Mbiemri | Kryesekretare | - | - |
| 6. | Emri Mbiemri | Sekretare e Departamentit të Infermierisë | - | - |
| 7. | Emri Mbiemri | Sekretare e Departamentit të Kujdesit Shëndetësor | - | - |
| 8. | Emri Mbiemri | Laborante e Laboratorit Klinik-Mikrobiologjik | - | - |
| | | **Departamenti i Infermierisë** | | |
| 1. | Emri Mbiemri | Drejtues Departamenti | - | - |
| 2. | Emri Mbiemri | Drejtuesi i Grupit Mësimor të Infermierisë | - | - |
| 3. | Emri Mbiemri | Drejtuesi i Grupit Kërkimor shkencor i përkohshëm të Infermierisë | - | - |
| 4. | Emri Mbiemri | Koordinatori për marrëdhëniet me studentët | - | - |
| 5. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 6. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 7. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 8. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 9. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 10. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |



Scanned with CamScanner

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 11. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 12. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 13. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 14. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 15. | Emri Mbiemri | Laborant | - | - |
| 16. | Emri Mbiemri | Laborant | - | - |
| **Departamenti i Kujdesit Shëndetsor** | | | | |
| 1. | Emri Mbiemri | Drejtues departamenti | - | - |
| 2. | Emri Mbiemri | Drejtuesi i Grupit Mësimor të Kujdesit Shëndetësorë | - | - |
| 3. | Emri Mbiemri | Drejtuesi i Grupit Kërkimor-shkencor i përkohshëm për grupet vulnerable dhe pabarazitë shëndetësore | - | - |
| 4. | Emri Mbiemri | Koordinatori për marrëdhëniet me studentët | - | - |
| 5. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 6. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 7. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 8. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 9. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 10. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 11. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 12. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 13. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 14. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 15. | Emri Mbiemri | Laborant | - | - |
| **Qendra Kërkimore Shkencore të Shëndetit** | | | | |
| 1. | Emri Mbiemri | Drejtues i Qendrës Kërkimore Shkencore të Shëndetit | - | - |



Scanned with CamScanner

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2. | Emri Mbiemri | Drejtuesi i Grupit Kërkimor-shkencor i përkohshëm "Determinantët e shëndetit, ndryshimet klimatike dhe impakti në shëndet" | - | - |
| 3. | Emri Mbiemri | Drejtuesi i Grupit Kërkimor-shkencor i përkohshëm "Shëndeti i të rriturve, kujdesi kronik dhe politikat shëndetësore" | - | - |
| 4. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 5. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 6. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 7. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 8. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 9. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 10. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 11. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 12. | Emri Mbiemri | Staf akademik | - | - |
| 13. | Emri Mbiemri | Specialist | - | - |

Ky dokument u hyrë në Protokoll-Arkiv në datën 18.12.2024

Sp. Protokolli

Migena Berhani

[signature]



[signature]

Scanned with CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

2133/2
12.12

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE**
**DEKANI**

Nr. 3101/3 Prot.

Vlorë, më 11.12.2024

Lënda: Përcjellje e strukturës akademike të planifikuar për FSHTN-në

**REKTORIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**PROF. DR. AURELA SALIAJ**

Bazuar në shkresën tuaj nr. 2133 prot., datë 30.09.2024 *"Kërkesë për përcjelljen e strukturave të Njësive Kryesore"* po Ju përcjellim bashkëlidhur strukturën akademike bazë të planifikuar për Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore sipas grupeve kërkimore/shkencore si dhe Vendimin e Dekanit nr. 14 datë 11.12.2024 *"Për miratimin e numrit të stafit akademik me kohë të plotë dhe disa ndryshime në strukturën organizative, organigramën dhe emërtimin e Qendrës Kërkimore Shkencore në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore"*.

- Bashkëlidhur struktura akademike e planifikuar për FSHTN-në si dhe Vendimi nr. nr. 14 datë 11.12.2024

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj,

**DEKANI**

**Prof. Asoc. Miftar RAMOSAÇAJ**

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE**
**DEKANI**

Nr. 430/2 Prot. Vlorë, më 11.12.2024

**VENDIM**

Nr. 14 datë 11.12.2024

**"PËR**
**MIRATIMIN E NUMRIT TË STAFIT AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË DHE DISA NDRYSHIME NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE, ORGANIGRAMËN DHE EMËRTIMIN E QENDRËS KËRKIMORE SHKENCORE NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE"**

Në mbështetje të pikës 2 dhe 3 të nenit 23, pikës 4, 5 dhe 11 të nenit 25 të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", gërmës c, pikës 4 të nenit 9, pikës 2 dhe gërmës ë dhe f të pikës 3 të nenit 10, gërmës c të pikës 2, dhe pikës 4 të nenit 11, gërmës dh të pikës 2 të nenit 27 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, gërma d e nenit 12 si dhe neni 19 i Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Dekanati i Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore në mbledhjet e datës **06.12.2024 dhe datës 11.12.2024** vendosi ti paraqesi disa propozime Rektoratit dhe Senatit Akademik të UV-së për disa ndryshime strukturore në strukturën dhe organigramën e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore. Propozimet kanë të bëjnë me disa ndryshime në, Vendimin e Senatit Akademik Nr. 8, datë 14.02.2018 me Nr. 230/2 Prot., datë 15.02.2024, "Për Strukturën Organizative të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, i ndryshuar me Vendimin e Senatit Akademik Nr. 12, datë 27.02.2019 me Nr. 352/2 Prot., datë 01.03.2019, dhe Vendimin e Senatit Akademik Nr. 25 datë 08.05.2018 me Nr. 654/6 Prot. datë 21.05.2018 "Për riorganizimin e grupeve mësimore, kërkimore-shkencore të Njësive Bazë të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë", shkresës së MAS "Dërgohet për njohje dhe zbatim urdhri" "Për miratimin e disa ndryshimeve në Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë" si dhe bazuar në Vendimin e Dekanatit nr. 14 datë 11.12.2024 me nr. 430/2 prot., datë 11.12.2024 Dekani i FSHTN-së në mbledhjet e datës 06.12.2024 dhe 11.12.2024:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë strukturën organizative të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore me numër 76 të stafit akademi me kohë të plotë.
2. Të miratojë ndryshimin e emërtimit të Qendrës Kërkimore Shkencore nga "Qendër Kërkimore Shkencore" në "Qendër Kërkimore Shkencore në Shkencat e Aplikuara."
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha strukturat akademike të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore
4. Ky vendim i përcillet Rektorit dhe Senatit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DEKANI**
**Prof. Asoc. Miftar RAMOSAÇAJ**

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I EKONOMISË
DEKANI

3085
23 12 24

Senati, Akademik, Statuti

Nr. 267/5 prot. Vlorë, më 23. 12. 2024

**Lënda:** Dergohen vendimet

**PROF. DR. AURELA SALIAJ**
**REKTOR**
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Ne mbeshtetje te nenit 34, pika II, te Statutit te Universitetit "Ismail Qemali", Vlore, bashkelidhur kesaj shkrese gjeni:

1.Vendimin nr. 17, date 20.12.2024 "Per Miratimin e Emërimit të Qëndres Kërkimore Shkencore të Fakultetit të Ekonomisë.

Duke Ju falenderuar,

**DEKANI I FAKULTETIT TË EKONOMISË**

**Prof. Asoc. Zamira SINAJ**

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORI

Nr. 30 Prot.

Vlorë më, 28.01.2025

**Lënda:** Specifikim i shkresës nr.3, prot, datë, 06.01.2024 "Përcjellje për mendim në Bordin e Administrimit, për ndryshimin e emërtimit të Qendrave Kërkimore Shkencore në fakultetet e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

**BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË**
**Z. SOTIR NIKOLLA**

**KËTU**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, gërma c, të ligjit Nr.80/2015"*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma c, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, po ju përcjellim ndryshimet në nenin 78, të Statutit të UV-së si më poshtë vijon:

**Ishte:** Neni 78, pika 4

**Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit**

Statusi i studentit nuk mund të vazhdojë për një kohëzgjatje më të madhe se dyfishi i kohëzgjatjes normale të programit të studimit të zgjedhur. Në rast se kjo kohë tejkalohet, kryesekretari i fakultetit i propozon dekanit çregjistrimin e studentit. Procedurat e çrregjistrimit përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.

**Bëhe** : Neni 78, pika 4

**Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit**

4. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë së se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.Procedurat e çrregjistrimit përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.

**Shtohet pika 5**

5. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet në të njëjtin program studimi ose një program tjetër. Ai u nënshtrohet kritereve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të institucionit pritës. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen me vendim të njësisë bazë të institucionit që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e saj.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

**REKTOR**

**Prof. Dr. Aurela Saliaj**

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Ëeb-site: ëëë.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK

Nr.43 Prot

Vlorë më, 08.01.2025

**Lënda:** Mbi ndryshimin e disa prej neneve të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

**REKTORIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË**
**PROF.DR. AURELA SALIAJ**

**KËTU**

Në zbatim të nenit 33 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe të Draft-Raportit për kontrollin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të ushtruar nga MAS ardhur me shkresën nr.4506/1 prot, datë 15.07.2024 si dh duke patur parasysh se në nenin 78 të Statutit, pika 4 nuk është sipas përcaktimit të ligjit nr.80/2015 neni 90, më poshtë po ju përcjellim ndryshimet e mëposhtme:

**Ishte:** Neni 78, pika 4

**Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit**

Statusi i studentit nuk mund të vazhdojë për një kohëzgjatje më të madhe se dyfishi i kohëzgjatjes normale të programit të studimit të zgjedhur. Në rast se kjo kohë tejkalohet, kryesekretari i fakultetit i propozon dekanit çregjistrimin e studentit. Procedurat e çrregjistrimit përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.

**Bëhet**: Neni 78, pika 4

**Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të studentit**

4. Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë së se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet.Procedurat e çrregjistrimit përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.

**Shtohet pika 5**

5. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet në të njëjtin program studimi ose një program tjetër. Ai u nënshtrohet kritereve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të institucionit pritës. Kreditet e grumbulluara nga studenti gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen me vendim të njësisë bazë të institucionit që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e saj.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**PËRGJEGJËS SEKTORI**

**Gentjana BELULAJ**